




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. DPK	Nr. Prot. B-Prot. Prot. No. 03-02/3867/17
Nr. Urag. (Broj. stranica) 02	Data Datum Date 22.11.2017



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 22.11.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2450/17, për zyrtarin e lartë z.Besim Muhadri, Anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik .

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-2450/17, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z.Besim Muhadri, Anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani".

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit, është vërejtur se zyrtari i lartë z.Besim Muhadri, figuron si person i autorizuar në biznesin privatë me emër Ndërmarrja Botuese "Bogdani" e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z.Muhadri, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe është interesuar për një takim me zyrtarët e AKK-së për tu njoftuar për situatën që është duke u trajtuar.

Ne takimin e organizuar në zyrat e AKK-së, me zyrtarin z. Besim Muhadri, zyrtarët e AKK-së, e kanë njoftuar zyrtarin e lartë me faktet që posedon Agjencia lidhur me rastin e iniciuar për të.

z. Muhadri, është pajtuar me gjendjen por është arsyetuar se nuk ka pasur njohuri dhe ka deklaruar se nuk ka qenë në dijeni se figuron si person i autorizuar në këtë biznes pasi që nuk është i angazhuar që një kohë në këtë biznes, por është zotuar se brenda afatit ligjor do të veproj sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit duke sjellë dëshmi se nuk do të figuroj si person i autorizuar në këtë biznes.

Pas këtyre veprimeve nga z.Besim Muhadri, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se zyrtari i lartë z.Besim Muhadri, nuk figuron me si person i autorizuar në biznesin privatë me emër Ndërmarrja Botuese "Bogdani" me nr.80287259.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga z.Besim Muhadri, Anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", duke bërë ndryshimet e parapara, duke hequr dorë nga përgjegjësit dhe të drejtat e funksionit si personi i autorizuar në biznesin privatë janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

